# KONTRATE E FORMIMIT TE SHOQERISE
# ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
# "KOMPANIA KIMIKE VITAL Z & D"SH.P.K.

Sot me dt 10,1,1995 midis te nenshkruarve

Patrit Zaimi i biri i Faikut dhe Sadberes, lindur me 24,2,1951 ne Tirane e banues ne Rr,Durresit P,11 shk,4 ap,31 madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, me leter njoftimin Nr,QH 021922,

Ilir Dusha i biri i Mehmetit dhe i Xhanes lindur me 21,7,1950 ne Tirane, banues ne Rr,Grigor Heba p,12, ap,7, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaport Nr,020520, arrihet marveshja per formimin e shoqerise "KOMPANIA KIMIKE VITAL Z & D" Sh,P,K, e cila do te rregullohet ne baze te legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe normave qe vijojne,

## Neni 1.

Ortaket do te kryejne veprimtari tregtare nepermjet nje shoqerie te pergjegjesise kufizuar te quajtur "KOMPANIA KIMIKE VITAL Z & D" me seli qendrore ne Rr,"Durresit" P,11 sh,4 ap,31 Nr,54 Tirane,

Koha zgjatja e shoqerise eshte fiksuar mbi 10 vjet dhe mund te shtyhet ose te zgjidhet para kohe me vendim te mbledhjes se ortakeve,

Ne baze te kontrates ne fjale veprimtaria e shoqerise dhe qeverisja e saj do te behet konform me statutin e shoqerise dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi,

## Neni 2.

Shoqeria ka per objekt;

a, Zhvillon aktivitet tregtar e prodhues per vete e te trete, brenda e jashte vendit te produkteve te industrise kimike e farmaceutike, importimin e eksportimin e prodhimeve te industrise kimike e farmaceutike, te materialeve te ndertimit e konsumit, makinerí e pajisje, si dhe ne fushen e transportit,

b, organizimin e konsulencave, perfaqesimeve dhe asistencave te specializuara ne fushen e industrise kimike e farmaceutike,

c, realizimin e kontratave sipermarrese, si sipermarres kryesor dhe kontrata sipermarrje ndertimi per impiante e linja te industrise kimike e farmaceutike te cdo lloji, ne fushen e turizmit, te sherbimeve publike, te ndertimit, bujqesise, marketingut etj,

## Neni 3.

Kapitali themeltar eshte 4553000 leke, eshte i ndare ne kuota njesi me nga 10000 lek secila, Ai perfaqson vleren e nje fabrike protoksidi te azotit,

Kuotat e pjesmarrjes jane nominative dhe te pandarshme,

Cdo kuote njesi prej 10000 leke i jep te drejten e nje vote,

Kapitali shoqeror nenshkruhet teresisht dhe po ashtu eshte shlyer nga ortaket, sipas kuotave pjesmarrese si vijon,

1, Patrit Zaimi 4507470 leke,

2, Ilir Dusha 45530 leke,

Ortaket kane te drejte te shtojne kuotat e tyre sipas rregullave te statutit te shoqerise,

Neni 4

Te ardhurat e realizuara nga shoqeria "KOMPANIA KIMIKE VITAL Z & D" do te ndahen pjeserisht ose totalisht ndermjet ortakeve sipas perqindjes se pjesmarjes ne kapitalin themeltar, pasi te jete lene menjane nje shuma te paktem ne 1/20 e tij e cila destinohet per formimin e fondit rezerve,Kjo lenie menjane nuk eshte me e detyrueshme kur "rezerva e domosdoshme" arrin 1/10 e kapitalit themeltar,

Ortaket mund te bien dakort te riinvestojne te ardhurat, ose nga ushtrimi ne ushtrim ti destinojne sipas vendimit te mbledhjes,

Cdo njeri prej ortakeve ka te drejten te transferoje, te perdore ose te ruaje pjesen e vet te te ardhurave,

Neni 5

Shoqeria duke vepruar ne Republiken e Shqiperise, mund te zgjeroje veprimtarine e vet ne bashkepunim me persona fizik dhe/ose juridik vendas ose te huaj,

Neni 6

Kuotat shoqerore mundet me marveshje midis te gjalleve t'u lihen te treteve duke njohur te drejten e parablerjes ne favor te ortakeve te tjere sipas statutit,

Ne rastin e zevendesimit trashegimor, i cili do te shtrihet vetem tek femijet dhe bashkeshortja, do te aplikohen dispozitat e kodit civil shqiptar ne lend,

Neni 7

Organet e shoqerise jane;

1,Asambleja e Ortakeve,

2,Administratori,

Asambleja eshte organi me i larte drejtues i shoqerise,

Ortaket mund te perfaqesohen ne mbledhje vetem sipas ligjit,nga ortaket te tjere ose nga persona te besimit me prokure te rregullt te firmosur,

Neni 8

Firma shoqerore dhe perfaqsimi i shoqerise persa i perket te treteve dhe ne gjykim i takon Administratorit,

Administratore emerohen te dy ortaket Petrit Zaimi e Ilir Dusha,

Neni 9

Cdo mosmarveshje qe mund te linde ndermjet shoqerise dhe ortakeve do te zgjidhet sipas legjislacionit shqiptar,

Neni 10

Per sa nuk parashikohet ne kete kontrate do te aplikohen nenet e Statutit te shoqerise dhe dispozitat e legjislacionit Shqiptar,

O R T A K E T

Petrit Zaimi

Ilir Dusha

# S T A T U T

# I SHOQERISE

"KOMPANIA KIMIKE VITAL Z & D " Sh.p.k.

Ne Tirane, sot me dt 10.01.1995 ne ortakot, Ilir Dusha dhe Patrit Zaimi madhor me zotesi te plote juridike ne mbeshtetje te ligjes 7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare" dhe Nr.7667 dt 28.1.1993 "Per regjistrimin ne Regjistrin Tregtar ..." vendosem qe te miratojme kete statut baze per karakterin dhe veprimtarine e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "KOMPANIA KIMIKE VITAL Z & D" si me poshte;

## FORMA EMRI

Neni 1

Shoqeria e themeluar eshte shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar Sh.P.K. e emertuar "KOMPANIA KIMIKE VITAL Z & D "

Neni 2

Kohe zgjatja e shoqerise eshte per nje periudhe kohe mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar. Kjo periudhe mund te zgjatet ose edhe te shkurtohet me vendim unanim te mbledhjes se ortakeve.

## SELIA E SHOQERISE

Neni 3

Shoqeria seline e saj do ta kete ne Tirane, Rr Durresit p.11 shk.4 ap.32.

Shoqeria mund te hape vendqendrime te dyta operative, filjale, perfaqsi, ose agjensi ne te gjithe teritorin e vendit me vendim te mbledhjes se ortakeve.

## OBJEKTI I SHOQERISE

Neni 4

Objekt i veprimtarise se shoqerise eshte ;

a. Zhvillon aktivitet tregtar e prodhues per vete e te trete, brenda e jashte vendit te produkteve te industrise kimike e farmaceutike, importimin e eksportimin e prodhimeve te industrise kimike e farmaceutike, te materialeve te ndertimit e konsumit, makineri e pajisje, si dhe ne fushen e transportit.

b. organizimin e konsulenrave, perfaqesimeve dhe asistencave te specializuara ne fushen e industrise kimike e farmaceutike.

c. realizimin e kontratave sipermarrese, si sipermarres kryesor dhe kontrata sipermarrje ndertimi per impiante e linja te industrise kimike e farmaceutike te cdo lloji, ne fushen e turizmit, te sherbimeve publike, te ndertimit, bujqesise, marketingut etj.

Shoqeria do te kryeje gjithe veprimat tregtare, financiare qe lidhen me objektin kryesor te veprimtarise se saj dhe qe gjykohen te nevojshme e te dobishme prej saj.

## KAPITALI THEMELTAR

### Neni 5

Kapitali themelor i shoqerise eshte 4,553000, dhe perfaqsom vleren e fabrikes se Protoksidit te azotit ne kuotat pjesamrrese si me poshte:

1, Petrit Zajmi        4,507470 leke = 99% te kapitalit themeltar,
2, Ilir Dusha          45500 leke = 1% te kapitalit themeltar,

Pjeset respektive te kapitalit themeltar nenshkruhen teresisht dhe po ashtu shlyhen nga ortaket,

Ne asnje rast pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqsojne kontribute ne sherbime,

### Neni 6

Kapitali themeltar eshte i ndare ne kuota, vlera e te cilave eshte nga 1000 leke secicila,

Kuotat jane nominative dhe lirisht te transferueshme midis ortakeve,

Transferimi i kuotave behet vetem me akt noterial,

Cdo transferim i kuotave te te tretet i nenshtrohet te drejtes se parablerjes nga ortaket e tjere,

### Neni 7

Bashkimi i pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise nuk pas sjell shperberjen e shoqerise,

### Neni 8

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie, Trashegimia shtrihet vetem tek femijet dhe bashkeshortja, te cilet behen automatikisht ortak te shoqerise,

### Neni 9

Per tjetersimin e kuotave te treteve ortaku duhet te njoftoje shkreserisht shoqerine, e cila brenda 3 muajve nga dita e marrjes dijeni duhet te jape vendimin per lejimin e transferimit, vendim, i cili kerkon unanimitetin e ortakeve,

Ne raste se lind nevoja per vleresimin e kuotave, ortaket caktojne ekspert, Ne raste se nje gje e tille nuk arrihet prej tyre caktimi i ekspertit behet nga Gjykata e Rrethit Tirane,

### Neni 10

Fitimet e shoqerise ndahen midis ortakeve propocionalisht me kuotat pjesmarrese ne kapitalin themeltar te shoqerise,

## ORGANET E SHOQERISE, ASAMBLEJA E ORTAKEVE

### Neni 11

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte drejtues i shoqerise,

Vendimet e saj ne perputhje me ligjin dhe normat e ketij statuti jane te detyrueshme per te gjithe ortaket,

Neni 12

Asambleja e ortakeve vendos me mbi 50% te pjeseve te kapitalit themeltar per:

-Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve,

-Emerimin dhe shkarkimin e ekspertit kontabel,

-Miraton raportin e administrimit dhe te kontrollit,

dhe me vendim unanim;

-Miraton llogarite vjetore dhe ndarjen e fitimit,

-Ndryshimet ne statut

-Zvoglimin e rritjen e kapitalit themeltar

-Transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar tek te trete,

-Zgjatjen e kohes se veprimtarise se shoqerise ose likujdimin e saj,

-Shndrimin e shoqerise nga Sh.p.k ne shoqeri anonime.

Neni 13

Cdo ortak mund te perfaqsohet ne mbledhjen e asamblese nga nje ortak tjeter ose nje person i trete me prokure, mjaft qe ata te mos jene administrator te shoqerise.

Mandatet e perfaqsuesve verifikohen nga drejtuesi i mbledhjes.

Neni 14

Asambleja drejtohet nga administratori i cili ngarkon nje sekretar per te mbajtur proces verbakin e mbledhjes se ortakeve.

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 15

Shoqeria administrohet nga dy administrator te cilet jane njekohesisht dhe ortak themelues te shoqerise.

Administratori emerohet per nje periudhe te pakufizuar..

Administratore te shoqerise emerohen z.Petrit Zajmi e Ilir Dusha.

Neni 16

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise, qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj, me perjashtim te atyre kopetencave qe me ligj jane te asamblese se Ortakeve.

Neni 17

Administratorit i takon firma e shoqerise dhe perfaqsimi i saj perpara te treteve. Ai mund te delegoj nje pjese te kopetencave te tij cdo personi tjeter qofte ky dhe jo ortak.

Neni 18

Shoqeria nuk merr persiper veprimet e ndryshme te mundeshme te administratorit ne mardhenie me te tretet, te cilat i tejkalojne kompetencat e tij te percaktuara ne statut dhe ne aktin e emerimit.

Neni 19

Administratorit i ndalohet te kontraktoje me shoqerine ne cdo forme.

Ai pergjigjet perpara shoqerise per veprimet e kryera ne kundershtim me ligjin, statutin apo per faje te kryera gjate ushtrimit te detyres.

Pasojat e marrveshjeve te pamiratuara nga Asambleja e Ortakeve qe i sjellin dem shoqerise i ngarkohen administratorit.

Neni 20

Per detyrimet e lindura pas konstituimit te shoqerise do te pergjigjet vete shoqeria me mjetet disponuse te saj, kurse ortaket themelues te shoqerise do te pergjigjen per detyrimet e shoqerise vetem kur pasuria teresore e saj nuk arrin te shlyeje keto detyrime dhe ne cdo rast vetem brenda sasise se mjeteve te investuara ne kapitalin themelor te saj.

Neni 21

Mjetet e investuara per themelimin e shoqerise si dhe ato te shtuara gjate aktivitetit te saj regjistrohen ne librin afarist te shoqerise menjehere.

KONTROLLI I ORTAKEVE

Neni 22

Cdo ortak jo administrator ka te drejte dy here ne vit t'i paraqes kerkese me shkrim administratorit per te kerkuar sqarime lidhur me vazhdimin e veprimtarise se shoqerise. Pergjigja e administratorit i komunikohet ekspertit kontabel.

Ortaket qe zoterojne te pakten 1/10 e pjeseve te kapitalit themeltar mund te kerkojne gjyqesisht caktimin e eksperteve kontabel per verifikimin e nje operacioni apo te veprimtarise se shoqerise ne pergjithesi.

Neni 23

Asambleja e ortakeve ose gjykata emeron ekspertet kontabel, te cilet kane nje mandat 6 vjecar.

Neni 24

Shoqerite qe ne mbyllje te vitit financiar tejkalojne dy prej tre shifrave te meposhtme, jane te detyruara te caktojne ekspert.

Keto jane;- Bilanci ne mbyllje te vitit eshte 12 milion leke.

- Vlera e te ardhurave te qarkullimit, pasi eshte zbritur tatimi mbi qarkullimin ne mbyllje te vitit eshte 22 milion.

- Shoqeria ka mesatarisht 50 te punesuar gjate vitit.

PUNESIMI NE SHOQERI

Neni 25

Per realizimin e aktivitetit te saj ne rritje shoqeria mund te punesoje punonjes te specialiteteve te ndryshme me kontrate punesimi konform legjislacionit per maredheniet e punes.

I punesuari nuk merr pjese ne fitimet apo humbjet e shoqerise. Ai pergjigjet materialisht ndaj shoqerise per demin material qe i shkakton asaj gjate kryerjes se detyres ose nga pakujdesia e tij.

BILANCI DHE FITIMET

Neni 26

Pas perballimit te detyrimeve, taksave, tatimeve, shpenzimeve te ndryshme, ortakeve ju mbetet ne dispozicion fitimi neto.

Neni 27

Fitimi neto mund te perdoret per zgjerimin e aktivitetit themeltar, per shtimin e tij ne natyre ose ndahet sipas perqindjes se kontributit te kapitalit themeltar.

Neni 28

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31.12. te cdo viti.

Neni 29

Pasuria e shoqerise mund te sigurohet ne institutin e sigurimeve.

Neni 30

Bilanci vjetor duhet te paraqitet brenda 31.3. te vitit pasardhes.

LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 31

Ne raste likujdimi te shoqerise, ortaket caktojne likujduesin mandati i te cilit nuk mund te jete me shume se tre vjet.

Pas shlyerjes se detyrimeve takuse fiskale dhe ato ndaj te treteve, likuiduesi ndan kapitalet e ngelura ndermjet ortakeve ne proporcion me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin themeltar.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 32

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet plotesimeve nga asambleja e shoqerise si dhe ligjit 7638 dt 19.11.1992.

Neni 33

Mosmarreveshjet juridiko civile te lindura midis personave pjesemarres ose jo ne shoqeri, kur nuk do mund te zgjidhen me mirekuptim me administratorin e shoqerise, do te zgjidhen nga gjykata kompetente shqiptare.

O R T A K E T

Petrit Zaimi

Ilir Dusha